



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës NR. 06/L-092, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 3 prill 2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes bën këtë:

**FTESË PUBLIKE  
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES  
NGA SHOQËRIA CIVILE**

Ftohen përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare - Shoqërisë civile të cilat veprojnë dhe kanë selinë në territorin e Komunës së Lipjanit, të dërgojnë propozimet e tyre për anëtarësim në Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës përkitazi me Propozim- Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme -- ZK Konjuh, i cili propozim- vendim pritet të miratohet në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës

Numri kërkuar : 1 (një) anëtarë nga Shoqëria civile.

Propozimet sipas mundësisë duhet të përfshijë personat me prioritet nga lëmi i shkencave juridike, ekonomike, bujqësore apo të ndonjë lëmie tjetër të pregaditjes superiore.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për shërbime për qytetarë brenda afatit 5 ditor nga dita e publikimit të kësaj ftese publike përkatësisht deri me datën 27.01.2025.

Ftesa të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr 01-020/04-4054  
Më datë: 22.01.2025

